



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 26.08.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: : “MIRËMBAJTJE E GODINËS SË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME, QË PËRFSHINË SISTEMET E KONDICIONIMIT, SHËRBIMI I
MIRËMBAJTJES SË KONDICIONERËVE TË DATA CENTER, ELEKTRIKE,
HIDRAULIKE DHE NDËRTIMORE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50000000-5 (Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,496,000 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë)
lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve (3 vitet e fundit financiar) të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik::

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 19% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit nenin 55, pika 4/b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme profesionale të shoqërisë në zbatim punimesh.

Liçenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

- Kategoria NP-3-A, Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasade (pasi kemi punime ndërtimore prishje, lyerje, pllaka etj)
- Kategoria NS-2-A, Impiante hidro-sanitare dhe mirëmbajtja e tyre (sistemi hidraulik i godinës, tubacione, pompa, tualete etj)
- Kategoria NS-4-A, Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese, (kemi suvatime, rifinitura me materiale druri etj.)

- Kategoria NS-12-A, Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit (sistemi HVAC kondicionimi i godinës)
- Kategoria NS-13-A, Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacionit (linjat e brendshme telefonike VOIP)
- Kategoria NS-14-A, Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj, (Sistemi elektrik)

Argumentimi: (Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, sipas V.K.M -së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/a “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.)

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 te VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”:

Kategoritë e sipëreshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve.

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ARGUMENTIMI TEKNIK I ZËRAVE TË PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	ARGUMENTIMI TEKNIK I NIVELIT TË KLASIFIKIMIT TË KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE BAZUAR NË PREVENTIV
<u>Kategoria NP-3-A</u>	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Nevojitet licenca pasi kemi punime arkitekture dhe konstruktive	A, 0-20 milionë lekë bazuar ne preventiv
<u>Kategoria NS-2-A</u>	Impiante hidro-sanitare dhe mirëmbajtja e tyre (sistemi hidraulik i godinës,tubacione, pompa, tualete etj)	Nevojitet licenca pasi kemi: Sistem hidraulik furnizimi me uje te godines	A, 0-20 milionë lekë bazuar ne preventiv
<u>Kategoria NS-4-A</u>	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike,metalike dhe	Nevojitet licenca pasi kemi punime shtresash, punime suvatimi, tavani dhe veshje, punime murature	A, 0-20 milionë lekë bazuar ne preventiv

	xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese		
<u>Kategoria NS-12-A</u>	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit (sistemi HVAC kondicionimi i godinës)	Kemi sistemin kryesor të kondicionimit të godinës dhe dhomes së serverave	
<u>Kategoria NS-13-A</u>	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacionit (linjat e brendshme telefonike VOIP)	Kemi linjat telefonike të brendshme, VOIP etj	
<u>Kategoria NS-14-A</u>	Impiante të brendshme	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj, (Sistemi elektrik)	

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencat e drejtuesve teknik (inxhinierë) që do të përfshijë për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë shënuar:

- a. 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier elektrik/elektronik

Për inxhinierët e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë këto dokumenta:, kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, librezë pune si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën periudhën 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit.

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimumi :

- 1 (një) specialist me certifikatë për mirëmbajtjen e sistemit ngrohje ftohje VRF.
- 1 (një) specialist për sistemet BMS/SCADA (ndërhyrje në sistemin e brendshëm të impianteve)
- 1 (një) punonjës elektrikist
- 1 (një) punonjës hidraulik
- 1(një) punonjës mekanik
- 1(një) punonjës bojaxhi.
- 1(një) punonjës teknik ashensori(mirëmbajtje ashensori)
- 1(një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë

- **1(një) punonjës të kualifikuar si specialist/ekspert zjarrfikës, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, (në përputhje me pikën 4, të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 „Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin“, të pajisur me certifikatën përkatëse të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i pajisur me Licencë, ose me kontratë për periudhën e zbatimit të kontratës vërtetuar me kontratë pune.**

Për punonjësit e sipërcituar ose duhet të jenë diplomuar sipas profesioneve përkatëse (diplomë e shkollës së mesme) ose të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, ISHTI ose ekuivalente me to të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma a) ; b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë, duhet të disponojë fuqi punëtore mesatarisht të paktën: 10 (dhjetë) persona duke përfshirë stafin e përhershëm, për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe V.K.M -së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe 6/ç), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.
- Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve dhe grafikut të punimeve. Argumentim teknik: Grafiku punimeve është 40 dite kalendarike e cila konvertohet në 30 dite pune. bazuar në preventivin e punimeve analizën e çmimit janë më tepër se 2400 ore pune e barabarte me 10 punonjës x 8 ore pune në dite x 30 dite.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës Të Vetëdeklarimit (Shtojca 10).

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (origjinal ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.

2.3.5. “Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë këto çertifikata në përputhje me objektin e prokurimit (të vlefshme ose ekuivalente dhe të akredituara nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë):

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë), (e vlefshme) ose ekuivalente,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit), (e vlefshme) ose ekuivalente,
- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), (e vlefshme) ose ekuivalente,**
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit BS PAS 99:2012 (për sistemin e menaxhimit të integruar), (e vlefshme) ose ekuivalente”.

Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme ose ekuivalente dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, (e vlefshme) ose ekuivalente,

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

Ky kriter është përcaktuar për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të mjedisit. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit kthehet në një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe më efikase për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001.

Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

- *Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë,*
- *Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe*
- *Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet”*
- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), (e vlefshme) ose ekuivalente**

Ky kriter është përcaktuar për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë në punë. OHSAS 18001 është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë.

- **Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit BS PAS 99:2012 (për sistemin e menaxhimit të integruar), (e vlefshme) ose ekuivalente.**

Ky standart lehtëson aplikimin i një sistemi të integruar të menaxhimit, i cili vjen me një numër përfitimesh në krahasim me zbatimin individual të secilit standard. Disa nga këto përfitime përfshijnë: zvogëlimin e vëllimit të dokumentacionit, administrim më të lehtë ose kostot e ulta të certifikimit.

PAS 99 përdoret për të mbështetur integrimin e një sistemi menaxhimi. Ai siguron një strukturë për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar të menaxhimit.

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme)

Argumentimi: (Referuar VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1 si dhe Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 79, Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë certifikata të lëshuara nga një organ i akredituar ose organizma ndërkombëtarë, me qëllim që, operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën, të jenë çertifikuar në sistemet e menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe menaxhimin e integruar, në përputhje me objektin e kësaj kontrate dhe e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë.

Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.

Në rastet e bashkimit të O.E, secili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë numrin dhe llojin e makinerive, paisjeve në pronësi/qera për realizimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

LLOJI I MAKINERIVE	NJËSIA	SASIA
Kamioncine kapaciteti mbajtes mbi 3.5 Ton	cope	1
Autovetura 4+1	cope	1
Gjenerator 10 kva	cope	1

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojces nr. 9 dhe dokumentacioni si më poshtë:

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni, taksat vjetore, çertifikata e transportit, çertifikata e kalibrimit të tahogرافit (të gjitha të vlefshme) dhe fotografi e mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni, taksat vjetore, çertifikata e transportit, çertifikata e kalibrimit të tahogرافit (të gjitha të vlefshme) dhe fotografi e mjetit, të shoqëruara me kontratën përkatëse të qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10 pjesa III. (Per përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës).

e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: (Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.)

Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt bazuar edhe në dokumentacionin teknik të projektuesit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për **“Mirëmbajtje e Godinës së Drejtorisë së Përgjithshme, që përfshinë sistemet e kondicionimit, shërbimi i mirëmbajtjes së kondicionerëve të Data Center, elektrike, hidraulike dhe ndërtimore”**, janë hartuar mbi bazën e Urdhrit Nr. 23, datë 23.05.2025, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 43**, datë **11.06.2025**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për

kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlogaritur vlerën limit të kontratës.*

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT